# KËRKESË PËR RISHQYRTIM

*Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Për: KUVENDI I KOMUNES DRAGASHI

Për Aktivitetin e Prokurimit:

| | |
|---|---|
| **Nr i Prokurimit** | **621-21-60-2-2-1** |
| **Nr i brendshëm** | **621-2021-001-221** |

Sa i përket tenderit për

**Hartimi i projekteve për nevojat e Kumunës së Dragashit ( 24 muaj)**

## 1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

*N.SH GEO-MAP*
*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

*PRISHTINË*
*(Adresa)*

*PRISHTINË* *(Vendi)*

*10000* *(Kodi postar)*

*044815477* *(Numri Telefonit)*

*(Numri i Faks-it)*

*FLORENT EMINI*
*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*

*geomapks@gmail.com*
*(Adresa elektronike)*

*23.02.2021*
*(Data e parashtrimit të kërkesës)*

N.SH. Geo-Map PRISHTINË
*(Nënshkrimi dhe vula)*

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

______________________________________________

*(Emri i avokatit)*

______________________________________________

*(Adresa e plotë)*

____________________ ____________________

*(Numri i Telefonit)* *(Numri i faks-it)*

____________________

*(Adresa elektronike)*

____________________ ____________________

*(Data e parashtrimit të kërkesës)* *(Nënshkrimi dhe vula)*

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

**Po** [x] **Jo** [ ]

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

**Po** [x] **Jo** [ ]

## 6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Neni 7
Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 28
Specifikimet teknike

Neni 59
Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Nenit 69
Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 80
Përbërja dhe vendimet e Jurisë

## 7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.*

1. Këtë kërkesë për rishqyrtim po e bëjmë bazuar në nenin 108/A - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve. Në vazhdim në detaje do të prezentojmë faktet dhe argumentet që dëshmojnë shkeljen e dispozitave të LPP-së.

Gjatë vlerësimit të dokumentacionit të kandidatit të shpallur fitues - konsorciumit **INSTITUTI DEKLIADA-ALB; AKSI PROJEKT SH.P.K.; FST Engineering SH.P.K.; " GRAPHITE ARCHITECTURE " SH.P.K.**, dëshmohet se janë bërë shkelje të dispozitave ligjore të LPP-së ngase në Raportin e Vlerësimit për këtë tender i askund nuk është evidentuar mospërmbushja e kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale dhe mosrespektimi i pikës 9.1 & 9.2 nen paragrafi b) të FDT

të Dosjes së këtij Tenderi.
Në vazhdim, po i prezantojmë këto shkelje ligjore:
Pas kerkeses per qasje ne dokumentet zyrtare të datës 18.02.2021 me datën 19.02.2021 kemi marrë dokumentacionin e kerkuar
a)Inxhinier i diplomuar i Elektrotekinkës-dega telekumunikacion z.Hivzi Kelemendi ashtu siç kërkohet në FDT të Dosjes së tenderit (tek pika 9.1 & 9.2 pragrafi b) pika (4)- **(4)-Minimum 2 elektroinxhinjera te diplomuar ose master minimum 3 vite përvoje pune pas diplomimit. (Njeri te jete me Drejtimin energjetik dhe nje tjeter drejtimi telekomunikacion).** *Dëshmia e kërkuar dokumentare* **2)Diplomat e inxhinierëve (kopje e noterizuar)(pranohen dhe noterizimet e skanuara)**
Po ashtu OE i shpallur fitues - konsorciumit **INSTITUTI DEKLIADA-ALB; AKSI PROJEKT SH.P.K.; FST Engineering SH.P.K.; " GRAPHITE ARCHITECTURE " SH.P.K.** nuk e ka permbushur këtë pikë ,pasi qe siq eshte kerkuar ne FDT të Dosjes së tenderit kerkohet Diploma kopje e noterizuar ,por OE i shpallur fitues - konsorciumit **INSTITUTI DEKLIADA-ALB; AKSI PROJEKT SH.P.K.; FST Engineering SH.P.K.; " GRAPHITE ARCHITECTURE " SH.P.K.**ka prezentuar Certifikaten e Diplomes .Po ashtu pas kerkeses per sqarime shtes nga ana e AK Operatrori ekonmik ka prezentuar Diplomen e fotografuar jo te noterizuar e cila shihet së eshtë marrë me datën 12.02.2021 d.m.th 3 ditë pas dorzimit te ketijë tenderit (andaj vertetohet se OE i shpallur fitues - konsorciumit **INSTITUTI DEKLIADA-ALB; AKSI PROJEKT SH.P.K.; FST Engineering SH.P.K.; " GRAPHITE ARCHITECTURE " SH.P.K.**nuk e ka pasur këtë diplomë para datës 09.02.2021 ashtu siq është kerkuar ne FDT të Dosjes së tenderit dhe eshtë ne kundershtim me nenin: ***Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë .Pika3: Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.***
*Shih dokumentin 1*

b) Inxhinier i diplomuar i Elektrotekinkës-dega energjetikë z.Agan Lezi ashtu siç kërkohet në FDT të Dosjes së tenderit (tek pika 9.1 & 9.2 pragrafi b) pika (4)- **(4)-Minimum 2 elektroinxhinjera te diplomuar ose master minimum 3 vite përvoje pune pas diplomimit. (Njeri te jete me Drejtimin energjetik dhe nje tjeter drejtimi telekomunikacion).** *Dëshmia e kërkuar dokumentare* **2)Diplomat e inxhinierëve (kopje e noterizuar)(pranohen dhe noterizimet e skanuara)**
OE i shpallur fitues - konsorciumit **INSTITUTI DEKLIADA-ALB; AKSI PROJEKT SH.P.K.; FST Engineering SH.P.K.; " GRAPHITE ARCHITECTURE " SH.P.K.** ,ka perzentuar Inxhinierin z.Agan Lezi i cili po ashtu figuron edhe ne listen e stafit te OE **N.N.SH"VIZION PROJECT"** qe gjitheashtu është pjesë e ketijë tenderi.(OE N.N.SH"VIZION PROJECT" Inxhinierin z.Agan Lezi e ka te deklaruar edhe në Administratën tatimore të Kosovës gjë e cila mund të vertetohet nese AK kerkon sqarime nga OE ose ATK),po ashtu OE fituese ka bër kontratë pune ne kundërshtim me ligjin pasi qe i njejti person posedon dy kontrata pune jo marrëveshje bashkëpunimi për projektet e veqanta.
*Shih dokumentin 2,3,4*

c) Inxhinieri i diplomuar i ndertimtarise drejtimi Hidroteknikë z.Astrit Salihu, ashtu siç kërkohet në FDT të Dosjes së tenderit (tek pika 9.1 & 9.2 pragrafi b) pika (3)- **(3)-Minimum 2 inxhinier të diplomuar të ndertimtarisë-drejtimi i hidrotektikes (ose master) minimum 3 vite përvoje pune pas diplomimit.** *Dëshmia e kërkuar dokumentare* **2)Diplomat e inxhinierëve (kopje e noterizuar)(pranohen dhe noterizimet e skanuara)**
Kemi verejtur se diploma e z.Astrit Salihut kopja e diplomës nuk është e noterizuar dhe e vulosur nga noteri (ne deshmin te cilen do ta bashkangjesim ne kete kerkese verehet se faqja e pare e diplomës nuk eshtë e vulosur ,ndersa ne faqen e dytë te bashkanqitur nuk shkruan se qfarë lloji i dokumentit eshtë noterizuar dmth.nuk shkruan as nurmi i diplomës as Diplomë por vetem shkruan se ky dokument eshte kopje nga origjinali)
*Shih dokumentin 5,6*
d) Në FDT të Dosjes së tenderit (tek pika 8.1 & 8.2) **Operatori ekonomik duhët të ofroj dëshmi të kënaqshme se qarkullimi vjetor gjatë 3 viteve të fundit ka qenë jo më pak se (200 000.00 €)** *Dëshmia e kërkuar dokumentare* **Raportin,raportet apo vërtetimet përkatëse nga një ose më shumë banka ose deklaratat vjetore ne ATK me të cilat dëshmohet se O.E ka pasur një qarkullim financiar në tri vitet e fundit sipas kërkesës së lartshënuar.**
OE i shpallur fitues - konsorciumit **INSTITUTI DEKLIADA-ALB; AKSI PROJEKT SH.P.K.; FST Engineering SH.P.K.; " GRAPHITE ARCHITECTURE " SH.P.K.**Nuk ka ofruar deshmi lidhur me qarkullimin bankar nga ndonje bankë ose nga Administrata Tatimore e Kosovës ATK.

Po ashtu, Gjatë kerkeses per qasje ne dokumentet zyrtare nuk janë prezentuar kerkesat e paraqitura ne FDT të Dosjes së tenderit **2) Operatori Ekonomik nuk duhet të jetë në falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësorë pranë ndonjë Gjykate kompetente e vendit të themelimit të Operatorit Ekonomik.** *Dëshmia e kërkuar dokumentare* **2) Një vërtetim i lëshuar nga Gjykata kompetente-(kopje). Vërtetimi kërkohet vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për dhënie të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të vendimit për dhënie të kontratës.(Valid)** po ashtu edhe **3)Operatori ekonomik nuk duhet të jetë delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit.**
*Dëshmia e kërkuar dokumentare*
**3) Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik-(Kopje). Vërtetimi kërkohet vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për dhënie të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të vendimit për dhënie të kontratës.(Valid)** për OE i shpallur fitues - konsorciumit **INSTITUTI DEKLIADA-ALB; AKSI PROJEKT SH.P.K.; FST Engineering SH.P.K.; " GRAPHITE ARCHITECTURE " SH.P.K.**

41.3 Parimet kryesore të procedurës së vlerësimit sipas LPP janë:

1. Tenderët duhet të plotësojnë substancialisht kërkesat formale administrative të specifikuara.
2. Tenderët duhet ët jenë të pranueshëm dhe duhet të përmbushin kërkesat

minimale të kualifikimit (nëse janë përcaktuar).
3. Tenderët duhet të plotësojnë substancialisht kushtet obligative teknike të specifikuara.
4. Tenderët e përgjegjshëm do të vlerësohen në bazë të kritereve të specifikuara të dhënies së kontratës.
5. Vetëm kërkesat dhe kritere e dhënies së kontratës të specifikuara në njoftim për kontratë/dosje të tenderit mund të përdorën si bazë për vlerësim.
6. Asnjë negocim nuk duhet të ndodhë në mes të autoritetit kontraktues dhe tenderuesve gjatë procedurës së vlerësimit, përveç komunikimeve që janë autorizuar saktësisht nga nenet 34 dhe 35 te LPP.
7. Megjithatë, vetëm sqarim i tenderëve mund të ndodhë pa ndonjë ndryshim të kushteve materiale ose aspekte të tenderit, përveç atyre te lejuara me nenin 59 dhe 72 te LPP-se.
8. Dhënia e kontratës do të bëhet në pajtim rigoroz me vlerësimin e kryer sipas 7 parimeve të cekura më lartë.

Prandaj, në bazë të këtyre argumenteve ligjore dëshmohet se konsorciumi i shpallur fitues i këtij tenderi **është i papërgjegjshëm** pasi nuk ka përmbushuir kërkesat për përshtatshmërisë profesionale dhe kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, të kërkuara me Dosjen e tenderit .

**8. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*
e) *Dokumentet e paraqitura ne kerkese nga dokumenti 1 deri te dokumenti 6*

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**
**"HASAN PRISHTINA"**

**REPUBLIC OF KOSOVO**
**UNIVERSITY OF PRISHTINA**
**"HASAN PRISHTINA"**

FAKULTETI I INXHINIERISË ELEKTRIKE DHE KOMPJUTERIKE NË PRISHTINË

FACULTY OF ELECTRICAL AND COMPUTER ENGINEERING IN PRISHTINA

# Diplomë Diploma

## HIVZI IBUSH KELMENDI

| | |
|---|---|
| U lind më 06.04.1980 në Prishtinë. | Born on 06.04.1980 in Prishtina. |
| U regjistrua në vitin akademik 1998/1999. | Was enrolled in the academic year 1998/1999. |
| Studimet i mbaroi më 21 shtator 2004 në: | Completed higher studies on 21 September 2004 in: |
| KOMPJUTERIKË ME TELEKOMUNIKACION | COMPUTER SCIENCES WITH TELECOMMUNICATION |
| dhe mori titullin: | and was awarded the title: |
| **INXHINIER I DIPLOMUAR I ELEKTROTEKNIKËS** | **GRADUATED ELECTRICAL ENGINEER** |
| Niveli i kualifikimit sipas **Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve: 6** | Level of qualification according to the **National Qualifications Framework: 6** |
| Nota mesatare gjatë studimeve 7,81 | Average grade of studies 7,81 |
| Nota e provimit të diplomës 10.00 | Diploma examination grade 10.00 |
| Prishtinë, 12 shkurt 2021 | Prishtina, 12 February 2021 |

Nr 725

Dekani / Dean
Prof. Asoc. Dr. Isak Shabani

Rektori / Rector
Prof. Dr. Naser Sahiti

VIZION PROJECT

# LISTA E STAFIT PROFESIONAL

| Nr | Emri dhe Mbiemri | Përgatitja Profesionale | Pozicioni ne kompani | Përvoja ne vite |
|---|---|---|---|---|
| 1 | MENTOR KRYEZIU | INXH. I DIP. I NDERTIMTARISË-KONSTRUKTIV | Menaxher i Projektit | 11 VITE |
| 2 | FIDAN SALIHU | MA. SC. I NDËRTIMTARISË - KONSTRUKTIV | Projektant I Strukturave | 8 VITE |
| 3 | SHKËLQIM OSMANI | INXH. I DIP. I ARKITEKTURËS | Projektant/Mbikëqyrës i Arkitekturës | 14 VITE |
| 4 | DRITON MURIQI | INXH. I DIP. I ARKITEKTURËS | Projektant/Mbikëqyrës i Arkitekturës | 11 VITE |
| 5 | LAVDIM OSMANAJ | INXH. I DIP. I HIDROTEKNIKËS | Projektant/Mbikëqyrës i Hidroteknikës | 14 VITE |
| 6 | ALKET KUMARAKU | INXH. I DIP. I HIDROTEKNIKËS | Projektant/Mbikëqyrës i Hidroteknikës | 20 VITE |
| 7 | AGAN LEZI | INXH. I DIP. I ELEKTROTEKNIKËS - ENERGJETIKË | Projektant/Mbikëqyrës i Energjetikës | 12 VITE |
| 8 | VALON ZHUNIQI | INXH. I DIP. I TELEKOMUNIKACIONIT | Projektant/Mbikëqyrës i Telekomunikacionit | 19 VITE |
| 9 | SEJDI BERISHA | INXH. I DIP. I MAKINERISË | Projektant/Mbikëqyrës i Makinerisë | 12 VITE |
| 10 | DURIM HOXHA | BACH. I DIP. I GJEODEZISË | Gjeodet i Licencuar | 8 VITE |

N.N.SH "VIZION PROJECT"
PRISHTINE

N.N.SH Vizion Project PRISHTINE REPUBLIKA E KOSOVËS

*Ne bazë te nenit 10 paragrafi 2, pikat 2.1 dhe 2.2, dhe nenit 11 të Ligjit të Punes Nr. 03/L-212 i shpallur ne Gazetën Zyrtare te Republikës së Kosovës, me dt. 01.12.2010, Punedhenesi dhe i Punësuari, si subjekte të marrëdhënies juridike të punës, lidhin*

## *KONTRAT PUNE me KUSHTE TE VEQANTA*

NENI 1

Në ketë kontratë: AKSI PROJKET sh.p.k me seli ne Prishtine, rruga Hyzri Talla-Bregu i Diellit, me numer unik identifikues 811 367 699 & Agan Lezi me pergatitje profesionale: Inxhinier I ELEKTROTEKNIKES

NENI 2

I punësuari sistemohet në vendin e punës: Inxhinier I ELEKTROTEKNIKES, detyrat e punës së punëmarrësit dhe përgjegjësit janë të përshkruara në shtes të posaqme e cila është pjësë e kësaj kontrate.

VIZION

# KONTRATE PUNE

E lidhur në Prishtinë me datë: **08.02.2021** në mes të:

**Emri Tregtar: N.N.SH. "VIZION PROJECT" - Emri i Biznesit Shkelqim Osmani B.I.** (punëdhënësi), me seli në Prishtine, **Numer Unik: 810540345** , **Nr.Fiskal: 600278370** të cilën e përfaqëson **z.Shkelqim Osmani Drejtor ligjor** , si dhe **Agan Lezi** (i punësuari) me profesion **Inxhninier i Diplomuar i Elektroteknikës** me banim në **Prishtinë.**

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**
**"HASAN PRISHTINA"**

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË DHE ARKITEKTURËS NË PRISHTINË

# Diplomë

## ASTRIT EMRUSH SALIHU

U lind më 03.01.1987 në Preshevë.
U regjistrua në vitin akademik 2010/2011 në studimet master.
Studimet i mbaroi më 26 janar 2017.
Gjithsej 120 pikë - ECTS
Nota mesatare gjatë studimeve 7.22
E mbrojti me sukses temën e masterit:
"Definimi i statusit të ujit sipërfaqsor-rast studimor në lumin Sitnicë"

DEPARTAMENTI I NDËRTIMTARISË
PROGRAMI STUDIMOR: HIDROTEKNIKË
Titulli i fituar:
**MASTER I SHKENCAVE TEKNIKE TË NDËRTIMTARISË**

Programi:
Hidroteknikë

Niveli i kualifikimit sipas **Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve: 7**
Prishtinë, 2 shkurt 2017

---

**REPUBLIC OF KOSOVO**
**UNIVERSITY OF PRISHTINA**
**"HASAN PRISHTINA"**

FACULTY OF CIVIL ENGINEERING AND ARCHITECTURE IN PRISHTINA

# Diploma

Born on 03.01.1987 in Presevo.
Was enrolled in the academic year 2010/2011 in master studies.
Completed his/her studies on 26 January 2017.
Total ECTS 120
Average grade of studies 7.22
Defended his/her Master thesis:
"Defining the status of surface waters -Sitnica River case study"

DEPARTMENT OF CIVIL ENGINEERING
STUDY PROGRAMME: HYDRO TECHNICIANS
Obtained the title:
**MASTER OF TECHNICAL SCIENCES-CIVIL ENGINEERING**

Programme:
Hydrotechnics

Level of qualification according to the **National Qualifications Framework: 7**
Prishtina, 2 February 2017

Nr. 67

Dekani / Dean
Prof. Dr. Abdullah Zejnullahu

Rektori / Rector
Prof. Dr. Marjan Dema

REPUBLIKA E KOSOVËS
NOTERE
Valdete I. Ademi
Rr."Bulevardi i Dëshmoreve të Kombit" nr.Hyrja 5 nr.4
Prishtinë

LRP nr.2884/2017
Kopje e origjinalit

----------------------------------VËRTETIM I -KOPJES NGA ORIGJINALI:----------------------------------

Valdete I.Ademi ,notere me seli në Prishtinë Rr."Bulevardi i Dëshmorëve të Kombit" hyrja 5 nr.4, me kërkesë dhe në prani të Astrit (Emrush) Salihu i lindur me datë 03.01.1987 (tre/Janar/njëmijë e nëntëqindë e tetëdhjetë e shtatë) në Preshevë, shtetas i Republikës së Serbisë i cili konstatohet me numër personal të pasaportës 0301987742925, lëshuar me date 04.11.2009 i vlefshëm deri me date 04.11.2019 me vendbanim në Fushë Kosovë, me kërkesë që të bëjë vërtetimin e origjinalit. ----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Kopja është identik me origjinalin e cila është sjellë nga ana e palës në zyrën e noterit Valdete I.Ademi, dhe e cila përputhet në tërësi me origjinalin, për përmbajtjen e të cilit noteri nuk merr përgjegjësi.----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Ky vërtetim lëshohet me kërkesë të palës konform nenit 43.1 të Ligjit të Noterisë, për nevoja personale. Ky akt u përpilua në Prishtinë me datë 25.09.2017 (njëzet e pesë/Shtator/dymijë e shtatëmbëdhjetë)----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

----------------------------------Valdete I Ademi, Notere----------------------------------